



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 197/6 prot.

Tiranë, më 14.5.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 738, datë 22.2.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 29.4.2024, është njoftuar vendimi nr. 738, datë 22.2.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 738, datë 22.2.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *AKSIK*) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si *KLP*), nga të cilat rezulton se:

**2.1 *ILDKPKI***, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gëzim Çopa”,<sup>2</sup> ka referuar se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- iii. *Ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**2.2 *AKSIK***, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit Raportin nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2017, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku pas administrimit të informacioneve nga autoritetet verifikuese, ka konstatuar: “Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z Gëzim \*\*\*\* Çopa”.<sup>3</sup>

**2.3 *KLP***, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin<sup>4</sup> për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

3. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar si vijon:

**3.1 *Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitet. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]<sup>5</sup>.

**3.2 *Për kontrollin e figurës.*** [...] Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Shkresa e ILDKPKI-së, me nr. \*\*/\*\* prot., datë \*\*.9.2018.

<sup>3</sup> Deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2023.

<sup>4</sup> Raport i KLP-së, nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.12.2018.

<sup>5</sup> Referohuni prg. 145.3 dhe 146, faqe 59 e vendimit.

përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...]”<sup>6</sup>.

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** [...] Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, dosjeve penale të administruara bazuar në indiciet/informacionet e përfituara nga institucionet e verifikimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se, në vlerësimin e përgjithshëm, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze, apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016 [...]”<sup>7</sup>.

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 dhe 4 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash<sup>8</sup>, ndër të tjera, ka vendosur:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

2. Transferimin e dosjes së procedimit penal me nr. \*\*\*, të vitit 2019, pranë organit kompetent (ILD-së) për inspektim.

## II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

**5.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**6.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**7.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet

<sup>6</sup> Referohuni prg. 156 dhe 157, faqe 62 e vendimit.

<sup>7</sup> Referohuni prg. 163 dhe 164, faqe 64 dhe 65 e vendimit.

<sup>8</sup> Znj. Xhensila Pine, kryesuese e trupit gjykues, ka votuar “kundër”, duke dalë me mendim në pakicë.

e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 738/2024, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 738/2024, të Komisionit, në tërësinë e tij.

### **III. Analiza e shkaqeve të ankimit**

#### ***III. A. Kontrolli i pasurisë***

10. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

12. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave vjetore periodike dhe atë "Vetting", dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në datën 27.1.2017, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

#### ***13. Pasuri të fituara me burim nga të ardhurat nga qiraja dhe nga punësimi pranë shoqërisë "\*\*\* \*\*"***

**13.1** Në D-Vetting dhe në DPDFD të vitit 2009 dhe 2015, subjekti ka deklaruar si pasuri: Tokë bujqësore 3.682 m<sup>2</sup>, në të cilën janë 300 m<sup>2</sup> truall dhe 56 m<sup>2</sup> ndërtesë, në adresën: \*\*\*, Durrës. Blerë në vitin 2002, në shumën 480.000 lekë. Kontratë blerje nr. rep. \*\*\*, nr. kol. \*\*\*, datë \*\*.11.2002. *Burimi i krijimit:* Nga qiraja e banesës me shoqërinë ndërkombëtare "\*\*\*\*", në vitet 1998-2003. *Pjesa takuese:* 100 %.

**13.2** Në D-Vetting dhe në DPDFD të vitit 2009 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Tokë bujqësore 2717 m<sup>2</sup>, fshati \*\*\*, Durrës, blerë në vitin 2003 dhe 2005, në vlerën prej 1.300.000 lekë. Kontratë shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.10.2003 dhe nr. rep. \*\*\*, nr. kol. \*\*\*, datë \*\*.3.2005. *Burimi i krijimit:* Qiraja nga "\*\*\*\*", në vitet 1998-2003. *Vlera:* 1.300.000 lekë. *Pjesa takuese:* 100%.

**13.3** Në *D-Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e shtëpisë në \*\*\*, Durrës, dhënë kompanisë “\*\*\* \*\*” dhe punësimi im si ekonomist në këtë shoqëri (nëntor 1998 - tetor 2003)<sup>9</sup>, në vlerën 155.800 dollarë<sup>10</sup>.

**13.4** Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar të ardhurat nga shoqëria “\*\*\*” si burim dhe në krijimin e disa pasurive të tjera, të luajtshme dhe të paluajtshme, sikundër do të trajtohen në vijim të këtij ankimi, respektivisht: *apartament banimi më sipërfaqe prej 150,9 m<sup>2</sup>, e ndarë në dy apartamente; tre garazhe; depozitë në \*\*\* Bank, me vlerë 13.000.000 lekë*, si dhe si burim për mbulimin e disa shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve.

**13.5** Lidhur me këto të ardhura dhe pasuritë për të cilat këto të ardhura janë deklaruar si burim krijimi, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se: [...] *duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor (në formën e kërkuar nga ligji) për të ardhurat e pretenduara me burim nga marrëdhënia e qirasë/punësimit me shoqërinë “\*\*\*” dhe as pagesën e detyrimeve tatimore mbi to, në kundërshtim me parashikimet e nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës [...]* <sup>11</sup>.

**13.6** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ mbi të ardhurat nga qiraja<sup>12</sup>, për të ardhurat nga punësimi i tij si ekonomist pranë kësaj shoqërie, ka prapësuar se: [...] *lidhur me formën juridike që ka pasur kjo shoqëri gjatë operimit të aktivitetit të saj në Shqipëri, nga informacionet e marra nga një ish-punonjës dhe nga çfarë kujton vetë, shoqëria “\*\*\*” ka pasur një marrëveshje me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., me seli në Durrës, për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë që punonin në këtë shoqëri, duke vënë në dispozicion dhe disa akte shoqëruese për të provuar pretendimet e tij [...]* <sup>13</sup>.

**13.7** Komisioni, në përfundim lidhur me këto të ardhura dhe pasuritë për të cilat këto të ardhura janë deklaruar si burim krijimi, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar<sup>14</sup> se: [...] *Komisioni çmon se ekzistojnë indicie/të dhëna/prova të mjaftueshme, të cilat, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë pasur marrëdhënie financiare me shoqërinë “\*\*\*” dhe se kanë përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie;*

*Mbi të ardhurat nga punësimi, në lidhje me detyrimet tatimore që rridhnin nga marrëdhënia me shoqërinë “\*\*\*” lidhur me këto të ardhura, Komisioni arrin në përfundimin se mospagimi i tatimit, nuk ka ardhur për faj të subjektit, sepse, referuar legjislacionit fiskal, detyrimin për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të punonjësve e kishte punëmarrësi (në këtë rast “\*\*\*” nëpërmjet shoqërisë “\*\*\*”);*

*Mbi të ardhurat nga qiraja dhe pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, në kushtet kur rezulton që shoqëria “\*\*\*” nuk ka qenë subjekt i regjistruar në organet tatimore shqiptare, Komisioni arrin në përfundimin se detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara*

<sup>9</sup> Subjekti ka detajuar dhe të ardhurat e realizuara: Nëntor 1998 – mars 2000, nga 1.000 USD në muaj. Mars 2000 - 30 tetor 2003, nga 3.200 USD në muaj. Në pagesën mujore në këtë periudhë ishte bashkë qiraja e banesës dhe paga ime si ekonomist.

<sup>10</sup> Në DV-2004, në momentin e fillimit të punës si OPGJ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar qira nga shtëpia, viti 2000-2004, paguar firma “\*\*\* \*\*”.

<sup>11</sup> Lidhur me këto të ardhura, Komisioni ka bërë të njëjtin konstatim në rastin kur për pasuritë e deklaruara nga subjektit si burim krijimi janë deklaruar të ardhura të përfituara nga qiradhënia dhe punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*”.

<sup>12</sup> Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në aktin: “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...”, prg. 29 i tij.

<sup>13</sup> Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve shoqëruese.

<sup>14</sup> Referohuni vlerësimit të Komisionit, në faqen 23 e në vijim të vendimit.

nga qiraja për të gjithë periudhën e ka pasur nëna e subjektit të rivlerësimit, si personi që ka nënshkruar marrëveshjet e qirasë me shoqërinë “\*\*\*” dhe, për rrjedhojë, ka përfituar të ardhura nga kjo marrëdhënie.

Por, nga ana tjetër, në kushtet kur nga Komisioni u pranua plotësisht provueshmëria e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, në vlerësim të faktit se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket nënës së subjektit, dhe duket se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duke vlerësuar përpjekjet e bëra në drejtim të sigurimit të informacionit mbi pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, si dhe në rrethanat kur duket i pamundur plotësimi i kushtit të pagesës së këtyre detyrimeve tatimore me vonesë, kjo përpos faktit të kohës së gjatë të kaluar nga përfitimi i këtyre të ardhurave, edhe për shkak se nëna e subjektit ka ndërruar jetë prej rreth 11 vitesh, e për rrjedhojë, subjekti si përfitues në vazhdim i këtyre të ardhurave apo i pasurive që rrjedhin nga ato nuk legjitimohet për kryerjen e këtyre pagesave, pranohet se këto të ardhura e kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 [...].

13.7.1 Për sa më sipër, Komisioni, pasi ka konsideruar si të ardhura të ligjshme të ardhurat e deklaruar nga marrëdhënia (e qiradhënies dhe punësimit) me shoqërinë “\*\*\*”, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit justifikon me burime të ligjshme pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, me të ardhurat e deklaruar përfituar nga kjo marrëdhënie.

**13.8 Komisioneri Publik**, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, për sa më sipër, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa vijon:

13.8.1 Në lidhje me të ardhurat nga shoqëria “\*\*\*”, nga aktet në dosje rezultojnë se deklaratimet e subjektit janë kontradiktore dhe nuk përputhen me provat shkresore të depozituara nga vetë subjekti<sup>15</sup> në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ, akte të cilat, fillimisht, vlerësohet se nuk provojnë realizimin dhe krijimin e të ardhurave nga qiraja para datës 20.3.2000.

13.8.2 Deklarimet e subjektit mbi këto të ardhura ndërmjet deklaratës së parë, dorëzuar në ILDKPKI, në vitin 2005 dhe Deklaratës “Vetting”, nuk përputhen si për shumën e të ardhurave, ashtu dhe për periudhën e realizimit të tyre, konkretisht:

13.8.2.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga qiraja e shtëpisë në \*\*\* Durrës, dhënë Kompanisë “\*\*\* \*\*\*” dhe punësimi im si ekonomist në këtë shoqëri (nëntor 1998 - tetor 2003), nëntor 1998 - mars 2003, nga 1 (një mijë dollarë muaji. Mars 2000 - 30 tetor 2003, nga 3.200 dollarë në muaj, në pagesën mujore në këtë periudhë ishte bashkë qiraja e banesës dhe paga ime si ekonomist.*

13.8.2.2 Në Deklaratën e parë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Qira nga shtëpia, vitet 2000-2004, 3.000 dollarë në muaj. Qira vjetore 36.000 USD. Pagar firma “\*\*\*” \*\*\*.

<sup>15</sup> (i) Kontratë qiraje (e panoterizuar) në gjuhën italiane, lidhur më datë \*\*3.2000, e cila referon marrëdhënien e qiradhënies midis familjes Çopa, nënshkruar nga znj. \*\*\* dhe “\*\*\*”, për periudhën \*\*3.2000-\*\*.12.2000, vlera e qirasë 3.200 USD/në muaj; (ii) Kontratë qiraje (e panoterizuar), në gjuhën italiane, e cila referon marrëdhënien e qiradhënies midis familjes Çopa, nënshkruar nga znj. \*\*\* dhe “\*\*\*”, për periudhën \*\*1.2001-\*\*.12.2001, vlera e qirasë 3.200 USD/në muaj, *ku është cituar se në këtë vlerë është e përfshirë edhe pagesa për punën part-time si ekonomist të z. Gëzim Çopa*; (iii) Kontratë qiraje (e panoterizuar), në gjuhën italiane, e cila duket se referon marrëdhënien e qiradhënies midis familjes Çopa, nënshkruar nga znj. \*\*\* dhe “\*\*\*”, për periudhën nga data \*\*1.2002 - \*\*.12.2002, për vlerën prej 3.200 USD/në muaj, *ku është cituar se në këtë vlerë është e përfshirë edhe pagesa për punën part-time si ekonomist të z. Gëzim Çopa*; (iv) Kontratë qiraje (e panoterizuar), në gjuhën italiane, e cila referon marrëdhënien e qiradhënies midis familjes Çopa, nënshkruar nga znj. \*\*\* dhe “\*\*\*” për periudhën nga data \*\*1.2003, \*\*.10.2003, për vlerën prej 3.200 USD / në muaj, *ku është cituar se në këtë vlerë është e përfshirë edhe pagesa për punën part-time si ekonomist të z. Gëzim Çopa*; (v) Lista e personelit “\*\*\*”, ku është i përfshirë edhe subjekti i rivlerësimit me profesionin “Ekonomist”.

13.8.2.3 Në përgjigje të barrës së provës së Komisionit, subjekti ka prapësuar se: *Të ardhurat që prindërit e mi kanë përfitur nga qiraja e shtëpisë, nga shoqëria “\*\*\*”, për periudhën nëntor 1998 - tetor 2003, janë në shumën 156.800 dollarë amerikanë.*

13.8.3 Në lidhje me të ardhurat e deklaruara të përfituara nga marrëdhënia e punësimit të subjektit pranë shoqërisë “\*\*\*”, nga aktet në dosje rezulton se deklaramet e subjektit janë kontradiktore dhe jo në përputhje me dokumentacionin e administruar, pasi:

13.8.3.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga punësimi im si ekonomist në këtë shoqëri (nëntor 1998 - tetor 2003), nëntor 1998 - mars 2003 nga 1 (një mijë dollarë muaji).*

13.8.3.2 Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, datë 5 Shkurt 2015, në përgjigje të pyetjeve të inspektorit përgjegjës, subjekti deklaron se: *“Nga puna ime part time në këtë shoqëri, unë kam fituar 2.000 USD në muaj. Unë nuk kam dokument punësimi nga kjo kompani”.*

13.8.3.3 Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit, subjekti, për herë të parë, deklaron se: *nga informacionet që mora nga një ish-punonjës që ka punuar në shoqërinë “\*\*\*” dhe çfarë u kujtova dhe vetë... shoqëria “\*\*\*” ka pas lidhur një marrëveshje me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., me seli në Durrës, për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë që punonin në këtë shoqëri<sup>16</sup>. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, marrë nga “\*\*\*” sh.p.k. dhe Drejtoria Rajonale e ISSH-së Durrës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2001-2003, është deklaruar nga kjo shoqëri dhe siguruar pranë ISSH-së për shumat minimale, rreth 9.000 lekë pagë bruto, shumata të cilat janë ndjeshëm më të ulëta se vlerat e pretenduara dhe deklaruara nga subjekti.*

13.8.3.4 Deklarimet e mësipërme kontradiktore të subjektit, si për shumat respektive të fituara, ashtu dhe për kohën e realizimit të këtyre të ardhurave, në mungesë dhe të akteve, provave të kohës mbi mënyrën e arkëtimit të këtyre të ardhurave, e bëjnë të vështirë përlllogaritjen e tyre për të evidentuar mundësinë financiare reale të subjektit për krijimin e pasurive të deklaruara.

13.8.4 Nga ana tjetër, edhe për sa i përket ligjshmërisë së këtyre të ardhurave në përmbushje të kërkesave të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja, deklaramet e subjektit, gjithashtu, vlerësohen si kontradiktore, pasi:

13.8.4.1 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Për sa i përket pagesës së tatimit mbi qiranë e banesës. Në dijeninë time, nëna ime, me gjithë moshën e saj, ka qenë gjithmonë e kujdesshme dhe duhet të jetë paguar ky detyrim ligjor, duke marrë parasysh dhe faktin që shoqëria “\*\*\*”, si shoqëri e huaj, ka pasur parasysh dhe këto detyrime kundrejt shtetit në momentin që ka lidhur marrëdhënien kontraktore në Shqipëri...*

13.8.4.2 Në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se: *(i) Duke qenë se nga momenti i ekzistencës së kësaj marrëdhënie qiraje... ka kaluar një periudhë kohore prej më shumë se 20 (njëzet) vitesh ...deklaroj se jam në pamundësi objektive për paraqitjen e*

<sup>16</sup> Subjekti depozitoi kërkesën dhe përgjigjen e shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., duke bashkëlidhur disa akte për herë të parë si: (i) marrëveshje të shoqërisë “\*\*\*” me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., për pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve shqiptarë që punonin në shoqërinë “\*\*\*”; (ii) tri fletë, fotokopje të listë-pagesave, të përgatitura nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., mbi bazën e listave të personelit të dërguara nga shoqëria “\*\*\*”, vetëm për qëllimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

*dokumenteve provuese lidhur me pagimin e tatim fitimit; (ii) Nga analiza e kuadrit ligjor rregullator mbi tatimin e të ardhurave me burim qiratë nga sendet e ndodhura në Republikën e Shqipërisë, nga viti 1994, e në vijim, vetëm për periudhën nga datat 15.1.1999 deri më 1.1.2002, detyrimi për vetë deklarimin e të ardhurave nga qiratë ka rënë mbi qiradhënësin - individ. Për periudhat e tjera, objekt analize, ka qenë detyrim i qiramarrësit - ndërmarrje, në rastin konkret, Shoqëria “\*\*\*\*”, që të përlllogaritë, mbante në burim dhe ta derdhte atë në llogari të shtetit, për pagesa të tjera për pagesa të kryera për qiratë.*

13.8.5 Për sa trajtuar më sipër, vlerësohet se të ardhurat e pretenduara “nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “\*\*\*\*”, nuk duhen përfshirë në analizë financiare në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si dhe mbulimin e shpenzimeve ndër vite, sipas deklarimeve të subjektit, ndërsa të ardhurat e pretenduara “nga marrëdhënia e punësimit të subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” duhet të konsiderohen deri në masën që provohet nga dokumentacioni i ISSH-së.

13.8.6 Në vlerësim të sa më sipër, dhe të gjitha akteve të administruara në dosje të Komisionit, si dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>17</sup>, **Komisioneri Publik** vlerëson se, sikundër ka rezultuar edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë si përfitimin e këtyre të ardhurave në kohën dhe shumën e pretenduar, ashtu dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, për të plotësuar standardin kushtetues e ligjor të të ardhurës së ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës.

#### **14. Pasuria: Apartament banimi më sipërfaqe prej 150,9 m<sup>2</sup>, e ndarë në dy apartamente, si dhe tre garazhe**

**14.1** Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi në rrugën “\*\*\*\*”, tani “\*\*\*\* \*\*\*\*”, 150,9 m<sup>2</sup>, ndarë në dy apartamente dhe tre garazhe me sipërfaqe secili: 21 m<sup>2</sup>, 21 m<sup>2</sup> dhe 20 m<sup>2</sup>, gjithsej 60,2 m<sup>2</sup>. Kontratë shitje, datë \*\* mars 2013. Prenotuar që në janar 2008. Deklaruar më parë, bashkë me ambientet e përbashkëta 174 m<sup>2</sup>. Saktësuar çmimi dhe sipërfaqet me kontratën e shitblerjes. Vlera: 142.000 euro. Burimi i krijimit: (i) Kredi në \*\*\*\* Bank 40.000 euro; (ii) Shitje Kalceto me sipërfaqe 648 m<sup>2</sup> në shumën 95.000 euro, në fshatin \*\*\*, \*\*\*, Durrës. Kontratë shitje nr. rep. \*\*\*, nr. kol. \*\*\*, dt. \*\*.11.2005, në vlerën 3.000.000 lekë, vlera fillestare ku Kalçeto sapo ishte nisur ndërtimi, por nuk kishin ardhur pjesët kompletuese të saj, të cilat janë sjellë e motuar nga kompania “\*\*\*\*”, në 6-mujorin e parë të vitit 2006. Investuar nga unë oferta e kompanisë 47.000 euro nga qiraja. Fitimi (95.000 – 47.000) euro; Burimi i investimit tim prej 47.000 euro nga qiraja dhe puna në “\*\*\*\*”, në vitet nëntor 1998 - tetor 2003; (iii) 7.000 euro nga shitja e tokës bujqësore me sipërfaqe prej 1.750 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 210.000 euro. Kontratë shitje nr. \*\* rep., \*\*/\* kol., datë \*\* janar 2013. Pjesa takuese: 100 %.*

**14.2** Në Deklaratën e parë, para fillimit të detyrës, në funksionin si Ndhimësinsektor i Lartë pranë ILDKPKI-së (dorëzuar në datën 19.1.2009), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 174 m<sup>2</sup> dhe 2 garazhe në rrugën “\*\*\*\* \*\*\*\*”, blerë në vitin 2008, në shumën 133.000 euro, me kontratë sipërmarrje e përfunduar, por e pahipotekuar, paguar 130.000 euro. Burimi i krijimit: Kredi \*\*\*\* Bank në shumën 35.000 euro. Shitje toke are 2.717*

<sup>17</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 19, datë 26.7.2019 të Kolegjit, prg. 68-69.



*m,<sup>2</sup> në të cilën është edhe fusha e minifutbollit dhe lokali më sip. 1.400 m,<sup>2</sup> në shumën 95.000 euro. Vlera: 130.000 euro<sup>18</sup>. Pjesa takuese: 100%.*

**14.3** Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: (i) *shumën prej 5.000 euro si detyrim të papaguar ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e apartamentit të banimit në rrugën “\*\*\* \*\*\*”, Tiranë, shumë për të cilën referon se do të paguhet në momentin e hipotekimit; dhe (ii) kredinë e marrë në \*\*\* Bank, në datën \*.10.2008, në shumën prej 40.000 euro (detyrim i mbetur 38.700 euro).*

**14.4** Në DV-2009, subjekti ka deklaruar se nga deklarimi i një viti më parë shtohet kontrata paraprake me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., e bërë në tetor 2009, për blerjen e një garazhi në pallatin ku ka dhe apartamentin, me sipërfaqe 21,2 m<sup>2</sup>, me vlerë 18.000 euro. Paguar 8.000 euro, me burim 3.000 euro nga paga dhe 5.000 euro nga mbyllja e llogarisë në \*\*\* Bank. Në seksionin e detyrimeve financiare të kësaj deklarate, ka deklaruar: (1) Detyrim financiar ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., për blerjen e garazhit, shumë prej 10.000 euro; (2) Shlyerje tek “\*\*\*” sh.p.k., shumë prej 3.000 euro.

**14.5** Në DV-2010, në lidhje me kredinë e marrë në \*\*\* Bank, në dhjetor të vitit 2008, subjekti ka deklaruar se me kërkesën e tij banka shtoi në kredi shumë prej 5.000 euro. Pra, kjo kredi në total është 45.000 euro.

**14.6** Në DV-2013, subjekti ka deklaruar se ka shlyer detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., për garazhin e deklaruar më parë në rrugën “\*\*\* \*\*\*”, \*\*\* \*\*\*, në shumën prej 10.000 euro.

**14.7** Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, e vitit 2015, në funksionin si prokuror (dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.11.2015) subjekti i rivlerësimit ka të njëjtin deklaram mbi pasurinë objekt vlerësimi, sikurse deklarimi i bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**14.8** ASHK, Drejtoria Vendore Veri<sup>19</sup>, konfirmon se të gjitha këto pasuri janë të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

**14.9** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës për këto pasuri, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se: [...] *Subjekti ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me çmimin total të paguar dhe momentin e kryerjes së pagesave për blerjen e dy apartamenteve dhe tri garazheve. Gjithashtu, duket se nuk përputhet deklarimi i bërë mbi vlerën totale të këtyre pasurive, me vlerën e shënuar në kontratën e sipërmarrjes për katër pasuri dhe në DV-2009 për një pasuri, si edhe me vlerën e tyre të përcaktuar në kontratat e shitblerjes;*

*Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer deri në datën 19.01.2009, për likuidimin e shumës prej 144,054 euro nga çmimi total i përcaktuar për blerjen e 2 (dy) apartamenteve dhe 2 (dy) garazheve nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., si edhe për kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe/apo të evidentuara deri në këtë datë<sup>20</sup> [...].*

<sup>18</sup> Në rubrikën ku shënohet vlera e kësaj pasurie me numra është shënuar shuma prej 130.000 euro, ndërsa me fjalë referohet shuma prej njëqind e dyzet e tetë mijë euro.

<sup>19</sup> Shkresa me nr. \*\*\*/\* prot., datë \*.3.2021.

<sup>20</sup> Komisioni në analizën e kryer dhe përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit administrativ ka konstatuar pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit për periudhën 1.7.2005 - 19.1.2009, në vlerën - 8.917.058 lekë, pasi ka vlerësuar se, në lidhje me të ardhurat nga shitja e ambienteve të fushës së minifutbollit dhe tokës që lidhet me të, në deklarinë e bërë në ILDKPKI, në datën 30.6.2005, në funksionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore, subjekti nuk ka referuar lejen e ndërtimit dhe as ndonjë investim të kryer që lidhet me këtë pasuri, dhe pretendimet e subjektit për përfitimin në total të shumës prej 95.000 euro nga

**14.10** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, në mënyrë të përmbledhur, ka kundërshtuar barrën e provës, duke pretenduar se:

14.10.1 Në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht vlerën e plotë të çmimit të apartamentit të banimit së bashku me vlerën e garazheve, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ.

14.10.2 Për sa i përket burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën e Komisionit kryesisht mbi trajtimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë *truall + fushë minifutbolli*, duke iu qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ dhe pretendimit se ka përfituar në total shumën prej rreth 95.000 euro nga transaksioni i kryer për shitjen e tokës dhe pajisjeve të fushës së minifutbollit, si dhe duke evidentuar këtu se më parë ka pas investuar shumën 47.000 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e tij dhe familjarëve me shoqërinë “\*\*\*\*”.

**14.11** Komisioni, pasi vlerësoi prapësimet e depozituara nga subjekti, konkludoi se: *[...] ai nuk arriti të provojë bindshëm dhe me dokumentacion justifikues ligjor përfitimin në total të shumës 95.000 euro nga transaksioni i shitjes së truallit dhe pajisjeve të fushës së minifutbollit dhe as pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat shtesë të pretenduara si të përfituara nga ky transaksion. Gjithsesi, në një qasje proporcionale dhe objektive vlerësohet se, për efekt analize, për sa kohë është reflektuar si shpenzim shuma e deklaruar si e investuar në vlerën 47.000 euro, minimalisht do të reflektohet e njëjta shumë si e ardhur e përfituar pas shitjes së investimit të kryer në këtë pasuri, në kushtet kur në këtë rast nuk do t'i nënshtrohej pagesës së tatimit, pasi nuk pranohen të ardhura shtesë të përfituara nga ky transaksion.*

**14.12** Në përfundimin, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer deri në datën 19.1.2009, për likuidimin e shumës 144.054 euro nga çmimi total i përcaktuar për blerjen e dy apartamenteve dhe dy garazheve nga shoqëria “\*\*\*\*.” sh.p.k., si dhe për kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe/apo të evidentuara deri në këtë datë. (Referohuni tabelës nr. 3, f. 45 e vendimit.) Nisur nga ky rezultat i analizës financiare, si dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet e bëra mbi këto pasuri (deklaratimet periodike), të pashoqëruara me mungesë të burimeve financiare, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të subjektit për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**14.13 Komisioneri Publik**, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, pasi nga aktet në dosje konstatohet se:

14.13.1 Arsyetimi i Komisionit mbi përfshirjen si të ardhura nga shitja e pasurisë *tokë arë + fushë minifutbolli*, të vlerës së investimit prej 47.000 euro, nuk mbështetet në aktet në dosje. Kontrata e lidhur me blerësit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.11.2005, referon si çmim shitje të kësaj pasurie shumën prej 3.000.000 lekë, vlerë e cila rezulton e reflektuar dhe në kartelën e pasurisë dhe për të cilën, bazuar në ligjin në fuqi, janë paguar dhe detyrimet tatimore.

14.13.2 Përfshirja e shumës 47.000 euro nga ana e Komisionit si e ardhur nga kjo shitje, në referencë të shpenzimit të deklaruar nga subjekti (vetëm në DV-2009), në vlerësimin e

---

shitja e kësaj pasurie mbeten kryesisht të karakterit deklarativ. Për më tepër, nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën shtesë të pretenduar si të përfituar nga subjekti, në shumën prej rreth 70.000 euro, e cila përfaqëson diferencën e vlerës prej 95.000 euro (të pretenduar) me shumën prej 3.000.000 lekë (sipas kontratës së shitblerjes).

**Komisionerit Publik** nuk gjen mbështetje në aktet në dosje dhe nuk mund të konsiderohet e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

14.13.3 **Komisioneri Publik** vlerëson të drejtë konstatimin fillestar të Komisionit, pasi, bazuar në dokumentacionin shkresor të administruar në dosje dhe deklaratimet e bëra nga subjekti, rezulton si vlerë e shpenzuar shuma 47.000 euro dhe si vlerë e përfituar nga shitja e kësaj pasurie vetëm shuma 3.000.000 lekë, sipas përcaktimit të bërë në kontratën e shitblerjes. Pretendimet e subjektit për përfitimin në total të shumës 95.000 euro nga shitja e kësaj pasurie, mbeten kryesisht të karakterit deklarativ, si dhe mbeti e paprovuar pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën shtesë të pretenduar të përfituar.

14.13.4 Gjithashtu, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni pas vlerësimit të prapësimeve të subjektit, duket se në zërin *Të ardhura të mundshme të kursyera nga familja Çopa, deri në datën 1.7.2005*, është përfshirë dhe shuma prej 8.590.717 lekë, shumë e cila nuk shpjegohet se nga vjen dhe nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratat periodike vjetore apo pretenduar nga subjekti. Sikundër më sipër trajtuar, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga familja Çopa nga shoqëria “\*\*\*\*”, në pikën 13.8.6 të këtij ankimi, gjatë hetimit administrativ dhe ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara për krijimin e kursimeve ndër vite, mbeti e paprovuar. Përfshirja në mesin e burimeve të ligjshme të sa më sipër, ka ndryshuar ndjeshëm rezultatin financiar të analizës së kryer dhe ka çuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit mbulon me burime të ligjshme, krijimin e pasurive të mësipërme.

14.13.5 Për sa më sipër, **Komisioneri Publik** vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi pamjaftueshmërinë financiare në vlerën rreth 8,9 milionë lekë, të konstatuar nga Komisioni.

## 15. Depozitë në \*\*\* Bank, me vlerë 13.000.000 lekë

15.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë në \*\*\* Bank \*\*\**, në vlerën 13.000.000 lekë. *Krijuar në maj 2014*. Burimi i krijimit: *Bono thesari, krijuar nga shitja e tokës bujqësore. Kontratë shitje nr. rep. \*\*\**, nr. kol. \*\*\*/\*, dt. \*\*.10.2007, në vlerën 10.000.000 lekë dhe nga shitja tokë bujqësore me sipërfaqe 1.750 m<sup>2</sup> në vlerën e 210.000 euro. *Kontratë shitje nr. \*\* rep., \*\*/\* kol., datë \*\* janar 2013*. Vlera: 13.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

15.2 Në Deklaratën e Interesave Privatë para Fillimit të Detyrës të vitit 2009,<sup>21</sup> pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar: *Depozitë bankare në \*\*\* Bank, me afat vjetor, në shumën prej 7.000.000 lekë, krijuar në vitin 2007*. Burimi i krijimit: *Shitje toke bujqësore në vitin 2007, në shumën 10.000.000 lekë*. Vlera: 7.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

15.3 Në DV-2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *bono thesari në Bankën e Shqipërisë me maturim 1-vjeçar, vlera 7.000.000 lekë, burimi: llogaria që më parë gjendej tek \*\*\* Bank*.

15.4 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar shtesë të pasurisë në bono thesari, shumën prej 3.000.000 lekë, me burim: (i) *fondet në vlerën prej 1.000.000 lekë nga llogaria e bashkëshortes në \*\*\* Bank*; (ii) *shuma prej 750.000 lekë nga gjendja cash*; si edhe (iii) *pjesa tjetër nga interesat e bonove të thesarit dhe të ardhurat e tjera familjare*.

15.5 Në Deklaratën e Interesave Privatë para Fillimit të Detyrës të vitit 2015, në funksionin si prokuror, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Depozitë në \*\*\* Bank \*\*\**, në vlerën prej

<sup>21</sup> Në funksionin si Ndhmësinsektor i Lartë.

14.355.000 lekë, krijuar në qershor të vitit 2014. Burimi i krijimit: Nga shitja tokë bujqësore me sipërfaqe 1.750 m,<sup>2</sup> në vlerën e 210.000 euro. Kontratë shitje nr. \*\* rep., \*\*/\* kol., datë \*\*.1.2013. Vlera: 14.355.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

**15.6** Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pakësuar llogaria në \*\*\* Bank \*\*\*, në shumën prej 1.000.000 lekë. Tërhequr për shpenzime familjare dhe pagesë për shkollimin e dy djemve.*

**15.7** Nga aktet në dosje, lidhur me burimin e deklaruar: *të ardhura nga shitja e tokës në vlerën 10.000.000 lekë, është konstatuar se, në datën \*\*.10.2007, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit \*\*\*. \*\*\*, pasurinë e llojit tokë arë, me sipërfaqe 1.462 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Durrës, në shumën prej 10.000.000 lekë, pasuri të cilën subjekti e kishte blerë në datën \*\*.6.2005, në shumën prej 760.000 lekë.*

**15.8** Komisioni, në përfundim të hetimit, i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me konstatimin se: *Në kushtet kur rezulton se subjekti e ka shitur pasurinë e mësipërme për një çmim rreth 13-herë më të lartë nga çmimi i blerjes, vetëm pas rreth dy vjet e tre muaj pasi e kishte blerë, si edhe faktit se kemi të bëjmë me një pasuri të llojit “tokë arë”, Komisioni ngre dyshime mbi vërtetësinë e këtij transaksioni.*

**15.9** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

15.9.1 *Lidhur me natyrën e marrëdhënies që ka ekzistuar mes tij dhe shitësve të parë të kësaj pasurie, subjekti deklaron se kjo pasuri në vetvete origjinën e ka pasur nga familja e tij dhe se kontrata e shitjes ka qenë finalizimi i një marrëveshjeje të bërë më parë mes prindërve të tij dhe shtetasve \*\*\*. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*, të cilët ishin pronarë të kësaj sipërfaqeje toke dhe e kishin fituar këtë pronë me ligjin nr. 7501, “Për tokën”. Lidhur me kohën që është kryer ky transaksion, konflikti mes ish-pronarëve të vjetër dhe atyre që kishin përfituar në tokat e këtyre ish-pronarëve nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, ishte evident. Subjekti ka deklaruar se për nevojat e tij familjare vendosi ta shiste këtë sipërfaqe toke dhe se ka rënë dakord me blerësin \*\*\*. \*\*\*, të cilin deklaron se nuk e njihte më parë, për çmimin e shitblerjes së kësaj prone. Lidhur me çmimin e shitblerjes së kësaj pasurie, ai deklaron se ky çmim përputhet plotësisht me vlerën e tregut të vitit 2007.*

**15.10** Komisioni, në përfundim, i ka vlerësuar bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion ligjor provues shpjegimet dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi transaksionet e kryera lidhur me këtë pasuri. Kështu, në kushtet kur provohet marrëdhënia e posaçme e subjektit me shitësit e kësaj pasurie, si dhe nisur nga konkluzionet e aktit të ekspertimit mbi vlerën e kësaj pasurie në vitin 2007, të cilit Komisioni i jep fuqi provuese për sa kohë duket se ai gjen mbështetje në informacionet e agjencive imobilare të kohës, Komisioni arrin në përfundimin se nuk konstatohen problematika në kryerjen e këtyre transaksioneve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

15.10.1 Bazuar në analizën financiare të kryer, Komisioni arrin në konkluzionin se familja Çopa ka pasur të ardhura të disponueshme me burim marrëdhënien e krijuar me shoqërinë “\*\*\*\*”, si edhe ka krijuar të ardhura të tjera gjatë periudhës korrik 2005 – janar 2008, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e depozitës prej 7 milionë lekësh në \*\*\* Bank. Në këtë kontekst, Komisioni, përfundimisht, vlerëson se pasaktësia në deklaram, e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, nuk mund të konsiderohet si shkak që mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

**15.11 Komisioneri Publik**, për sa më sipër, ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me vlerësimin e këtij të fundit mbi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

15.11.1 Për sa i përket burimit të deklaruar, të ardhura të përfituara nga shoqëria “\*\*\*”, **Komisioneri Publik**, sikundër ka trajtuar gjerësisht dhe më sipër, në pikën 13.8.6 të këtij ankimi, vlerëson se gjatë hetimit administrativ për këto të ardhura nuk u provua se ato janë përfituar në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës.

15.11.2 Për sa i përket çmimit të shitjes së tokës në vitin 2007, **Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, ngre dyshime mbi vërtetësinë e çmimit të shitjes së kësaj pasurie, për sa kohë ai rezultoi rreth 13 herë më i lartë nga çmimi i blerjes në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe shpjegimet e tij mbetën në nivel deklarativ dhe jo bindëse, pasi nuk provohen me dokumentacion provues. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, është akti i ekspertimit i datës \*\*.2.2024, i hartuar në funksion të procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. \*\*\*/\*, ZK \*\*\*, rezultoi se, më datë \*\*.11.2007, kjo pasuri është regjistruar në emër të z. \*\*\*. \*\*\*, për vlerën 10.000 lekë, vlerë kjo shumë herë më e ulët se çmimi i deklaruar i shitjes së kësaj pasurie.

## **16. Analiza financiare ndër vite**

**16.1** Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga analiza paraprake financiare lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, për periudhat viti 1992 - 30.6.2005; 1.7.2005 - 19.1.2009; 20.1.2009 - 31.12.2009, si edhe për vitet 2010 - 2016, duket se periudhat 1992 - 30.6.2005; 1.7.2005 - 19.1.2009, si edhe vitet 2011, 2014 dhe 2015, i ka rezultuar balancë negative totale në shumën prej - 25.856.572 lekë<sup>22</sup>.

**16.2** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, përveç sa ka kundërshtuar sikundër trajtuar më sipër për analizën deri në vitin 2009, për diferencën e viteve 2011, 2014 dhe 2015, ka kundërshtuar dhe analizën e kryer nga Komisioni mbi zërat: shpenzime të shkollimit të fëmijëve për vitet respektive dhe të ardhurat e vitit 2011 të realizuara nga shitja e një gjeneratori në vlerën 1.300.000 lekë.

**16.3** Komisioni, në përfundim duket se ka vlerësuar të drejta pjesërisht pretendimet e subjektit, duke konkluduar për pamjaftueshmëri financiare vetëm për vitet 2011 dhe 2014, në vlerën – 986.669 lekë, pamjaftueshmëri e cila, në vlerësim të Komisionit, është në vlerë të tillë, e cila çmohet se nuk është e mjaftueshme për ta vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kjo edhe për shkak se duket se këto balanca negative nuk ndikojnë drejtpërdrejt në burimin e krijimit të pasurive të subjektit.

**16.4 Komisioneri Publik**, për sa më sipër, nuk e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit, pasi fillimisht mbi të ardhurën e pretenduar nga shitja e një gjeneratori në vitin 2011, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk e kanë deklaruar këtë të ardhur në deklaratat periodike vjetore, si dhe atë “Vetting”, sikundër pranuar dhe nga vetë subjekti në përgjigje të procesverbalit të ILDKPKI-së të datës 11.2.2015<sup>23</sup>. Rrjedhimisht, në vlerësimin e

---

<sup>22</sup> Sipas analizës së vënë në dispozicion të subjektit kanë rezultuar se: për periudhën viti 1992 -30.6.2005, balanca negative e fondeve – 13.473.315 lekë; për periudhën 1.7.2005 - 19.1.2009, balanca negative e fondeve – 8.917.058 lekë; për vitin 2011, balanca negative e fondeve – 256.540 lekë; për vitin 2014, balanca negative e fondeve – 1.933.021 lekë; për vitin 2015, balanca negative e fondeve – 1.276.638 lekë.

<sup>23</sup> I pyetur më parë nga ILDKPKI në lidhje me të ardhurat e depozituara *cash* në \*\*\* Bank, në shumën 1,300,000 lekë, në datën \*\*.4.2011, me përshkrimin “Të ardhura nga shitje gjeneratori”, subjekti ka deklaruar se: “...Ky është një gjenerator i

**Komisionerit Publik**, kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive dhe mbulimit të shpenzimeve për vitin 2011.

16.4.1 *Për sa i përket kundërshtimeve të subjektit mbi shpenzimet e shkollimit të llogaritura nga Komisioni, për vitet 2014-2015, në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto pretendime mbetën të pambështetura dhe të paprovuara.*

16.4.2 Përveç sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar shpenzime shkollimi vetëm në DV-2013, dhe jo në vitet në vijim (2014, 2015, 2016) në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, lidhur me detyrimin e subjekteve deklarues për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme me vlerë mbi 300.000 lekë për arsim, mjekim etj., duke e bërë deklarimin e subjektit për këto vite dhe të pasaktë.

16.4.3 Nga aktet në dosje, rezulton se Komisioni ka llogaritur shpenzime shkollimi për fëmijët e subjektit për vitet respektive, bazuar në të dhënat e Eurostat për shpenzime jetese dhe duke iu shtuar dhe tarifat vjetore të shkollimit<sup>24</sup>.

16.4.4 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit pranë \*\*\*-së për këto vite, kanë rezultuar transfertat në drejtim të institucionit arsimor: “\*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, \*\*\*.”, me përshkrimin: “\*\*\* \*\*\*, *inv academic year*”. Sikundër dhe vetë subjekti deklaron në përgjigje të Pyetësorit nr. 3 të Komisionit, shpenzimet që ai ka deklaruar për këto vite për djalin \*\*\*, janë bërë më shumë për udhëtime të ndryshme të kryera gjatë periudhës, çka duket se i shtohen pagesave të konstatuara nga lëvizjet në llogarinë bankare të subjektit pranë \*\*\*. Gjithashtu dhe dokumenti i vënë në dispozicion nga subjekti, i titulluar: “*Enrollment Confirmation*”, lëshuar nga \*\*\* \*\*\*, \*\*\* *in Switzerland*, nuk paraqet të dhëna të plota mbi faktin nëse nga ky institucion mbulohet vetëm pagesa e shkollës apo dhe shpenzimet e tjera të qëndrimit dhe të akomodimit të djalit të subjektit.

16.4.5 Për sa më sipër, në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës edhe për sa konstatuar nga Komisioni mbi burimet e ligjshme dhe pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për vitet 2011, 2014 dhe 2015, në vlerën rreth 3.400.000 lekë për këto vite.

### **Çështje të tjera**

**17. Shitja e tokës bujqësore, me sipërfaqe prej 1.750 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 210.000 euro (kontratë nr. \*\* rep., nr. \*\*/\* kol., datë \*\*.1.2013)**

**17.1** Në datën \*\*.11.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, është lëshuar Certifikata për Vërtetim Pronësie me nr. serial \*\*\*, për pasurinë me nr. \*\*\*/\*\*, volum \*, faqe \*\*\*, Z K \*\*\*, me sipërfaqe totale 3.500 m<sup>2</sup>.

**17.2** Subjekti i rivlerësimit ka bërë kërkesë për ndarjen e pasurisë me nr. \*\*\*/\*\*, të llojit ullishte me sipërfaqe totale prej 3.500 m<sup>2</sup>, regjistruar në volum \*, faqe \*\*, Zonë Kadastrale \*\*\*. Referuar kësaj kërkesë, sipas planit të rilevimit të paraqitur, subjekti do që ta ndajë në: (i) pasurinë nr. \*\*\*/\*\* - \*, me sipërfaqe prej 1.750 m<sup>2</sup>; dhe (ii) pasurinë nr. \*\*\*/\*\* - \*\*, me sipërfaqe prej 1.750 m<sup>2</sup>.

---

përdorur nga shoqëria “\*\*\*” dhe falur prindërve të tij, pasi u larguan nga Shqipëria. Nuk ka dokument, por konfirmon përgjigjen e bankës. Sqaron se ia ka shitur firmës “\*\*\*” me aktivitet shitje gomash, me administrator z. \*\*\* \*\*\*. Nuk e ka deklaruar si të ardhur të tijën, sepse veprimi i kryer ka qenë për llogari të nënës”.

<sup>24</sup> Sikundër detajuar në aktin “*Metodologjia e përdorur në analizën financiare*”, bashkëngjitur “*Rezultateve të hetimit administrativ*”.

**17.3** Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës ka bërë ndarjen e pasurisë me nr. \*\*\*/\*\*, në dy pasuritë si vijon: (i) Pasuria nr. \*\*\*/\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, ZK \*\*\*, e llojit *truall*, me sipërfaqe 1.750 m<sup>2</sup>; dhe (ii) Pasuria nr. \*\*\*/\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, ZK \*\*\*, e llojit *truall*, me sipërfaqe 1.750 m<sup>2</sup>.

**17.4** Në datën \*\*.12.2012, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa, janë lëshuar Certifikatat për Vërtetim Pronësie për dy pasuritë e sipërcituara.

**17.5** Në datën \*\*.1.2013, subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij i kanë shitur<sup>25</sup> shoqërisë “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., pasurinë me nr. \*\*\*/\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, ZK \*\*\*, e llojit *truall*, me sipërfaqe 1.750 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 210.000 euro, i barabartë me 29.400.000 lekë.

**17.6** Në DV-2013, në seksionin “*Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit*”, subjekti ka deklaruar shitjen e tokës bujqësore me sipërfaqe prej 1750 m<sup>2</sup> (përfutur me ligjin nr. 7501, “Për Tokën”), në vlerën prej 210.000 euro.

**17.7** Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me shitjen e kësaj pasurie.

**18. Komisioneri Publik**, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, ngre dyshime mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, në zbatim të nenit D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës. Në kartelën e pasurisë së paluajtshme për pasurinë nr. \*\*\*/\*\*, ZK \*\*\*, me sipërfaqe 1.750 m<sup>2</sup>, në emër të blerësve, nuk referohet asnjë vlerë e shumës së paguar për këtë pasuri sipas kontratës së shitjes të datës \*\*.1.2013, çka vlerësohet se duhet analizuar nga Kolegji në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, së bashku me shkaqet e tjera në ankim, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**19.** Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, **Komisioneri Publik**, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; dhe (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 3, i lidhur me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

### ***III. B. Lidhur me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale***

**20.** Komisioni, në funksion të verifikimit të informacioneve/sinjalizimeve të përfutura nga institucionet e verifikimit, ka administruar informacion dhe dokumentacion<sup>26</sup> për disa çështje gjyqësore penale, të referuara si të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, midis të tjerash për:

**21. Procedimi penal nr. \*\*\*/2019, datë \*\*.7.2019, në ngarkim të shtetasit \*\*\* \*\*\* e të tjerë**, të cilin, në përfundim të hetimit, bazuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka transferuar pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të shërbejnë si shkelje disiplinore.

**21.1** Referuar akteve në dosje të Komisionit rezulton se, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në qytetin e Kavajës, në datën \*\*.7.2019, ku si pasojë e të shtënave/shkëmbimit të zjarrit gjeti vdekjen shtetasi \*\*\*. \*\*\*, si edhe janë plagosur (me dëmtime të lehta trupore) disa shtetas të tjerë, po në datën \*\*.7.2019, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë

<sup>25</sup> Kontratë blerje trualli me nr. \*\* rep., nr. \*\*/\* kol., datë \*\*.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. \*\*\* \*\*\*.

<sup>26</sup> Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2023 dhe shkresat “kthim përgjigje” të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës: (i) me nr. \*\*\* prot., datë \_.\*\*.; dhe (ii) me nr. \*\*\*/\* prot., datë \*\*.01.2024.

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kavajë ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.7.2019<sup>27</sup>, për veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga nenet 79/ë, 25, 22, 278/1 e 300, të Kodit Penal.

**21.2** Subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, në datën \*\*.12.2019, ka urdhëruar ndryshimin e të dhënave në Regjistrin e veprave penale<sup>28</sup> dhe, në datën \*\*.12.2019, ka vendosur marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për: (i) personin nën hetim \*\*\*, \*\*\*, për veprën penale të “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 85 dhe 278/1, të Kodit Penal; (ii) Personat nën hetim, \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*, për veprën penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; dhe (iii) Për personin nën hetim \*\*\*, \*\*\*, për veprën penale të “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal.

**21.3** Pas përfundimit të hetimeve lidhur me këtë procedim penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kavajë (prokurori Çopa) ka përpiluar kërkesën për: (1) dërgimin në gjyq të çështjes, në ngarkim të shtetasve \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të sipërcituara; dhe (2) pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*.

**21.4** Pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kavajë, me vendimin nr. \*\*-2020-\*\* (14), datë \*\*.1.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Kavajë, subjekti i rivlerësimit, z. Çopa, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në përfundim të gjykimit të kësaj çështje ka kërkuar: (1) Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85, i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55, të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, me 7 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K. Pr. Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim; (2) Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406, të K. Pr. Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim; (3) Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*, \*\*\*, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406, të K. Pr. Penale, uljen e këtij dënimi me 1/3 dhe dënimin e tij me 10 muaj burgim.

---

<sup>27</sup> Subjekti i rivlerësimit, z. Çopa ka vendosur të regjistroj në regjistrin e çështjeve penale në prokurori emrat e shtetasve \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 79/ë, 22, 25 dhe 278/1 i Kodit Penal, si edhe të shtetasit \*\*\*, \*\*\*, i dyshuar për veprën penale të “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300, i Kodit Penal.

<sup>28</sup> (1) për personin nën hetim \*\*\*, \*\*\*, vepra penale që dyshohet është “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; (2) Për personin nën hetim \*\*\*, \*\*\*, vepra penale që dyshohet është “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; dhe (3) për personin nën hetim \*\*\*, \*\*\*, veprat penale që dyshohen janë “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 85 dhe 278/1 i Kodit Penal.



**21.5** Komisioni, me aktin “Rezultate të hetimit administrativ ...”, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, ku, ndër të tjera, i ka kërkuar: [...] *paraqisni në mënyrë të përmbledhur shpjegimet/argumentet tuaja mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat të cilat ju çuan në ndryshimin e cilësimit të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim* [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij në aktin “*Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...*”<sup>29</sup>.

**21.6** Sa më sipër, Komisioni, ka arritur në përfundimin<sup>30</sup> se: [...] *për shkak të rrethanave të ngjarjes dhe rrezikshmërisë së lartë shoqërore që paraqesin veprat penale për të cilat është regjistruar ky procedim, trupi gjykues çmon se duhet bërë verifikim i detajuar mbi arsyet/rrethanat/faktet/provat të cilat çuan prokurorin Çopa në ndryshimin e cilësimit të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim. Për këto arsye, vendosi ta transferojë këtë çështje penale pranë organit kompetent (ILD-së) për inspektim, me qëllim verifikimin dhe evidentimin e shkaqeve të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e prokurorëve, ose evidentimin e shkaqeve të cilat mund të merren parasysh në vlerësimin periodik të prokurorit Gëzim Çopa* [...].

**21.7 Komisioneri Publik**, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje të Komisionit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, dhe vlerëson se gjetjet e konstatuara në rezultatet e hetimit lidhur me këtë procedim penal janë të tilla, që nuk duhen transferuar pranë organit kompetent për inspektim, por, së bashku me gjetjet e tjera në kontrollin e pasurisë, si dhe të aftësive profesionale, duhen vlerësuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

21.7.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, pasi duket se nuk arriti të argumentojë arsyet/rrethanat/faktet/provat, të cilat çuan në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për dy të pandehur dhe kërkesën për pushimin e hetimeve për dy nga personat nën hetim, duke minimizuar rëndësinë e faktit penal dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

21.7.2 **Komisioneri Publik** vlerëson se gjetjet lidhur me këtë procedim, në konsideratë dhe të indicieve të institucioneve të verifikimit dhe raportit të AKSIK, duhen vlerësuar më së paku në drejtim të indikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3 dhe 75, pika 3, të ligjit nr. 96/2016.

### ***Denoncimet nga publiku***

#### **22. Denoncimi i shtetases \*\*\* \*\***<sup>31</sup>

**22.1** Denoncuesja, znj. \*\*\* \*\* pretendon zvarritje të hetimit penal, lidhur me kallëzimin e bërë për falsifikim të një dokumenti pronësie të babait të saj.

**22.2** Nga shqyrtimi i dosjes, Komisionit i kanë rezultuar, në mënyrë kronologjike, rrethanat e mëposhtme:

22.2.1 Pas kallëzimit të shtetasit \*\*\* \*\*, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Kavajë ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2019, për veprat penale parashikuar nga nenet 186/1 dhe 248, të Kodit Penal, dhe, në përfundim të hetimeve, i është drejtuar Gjykatës së

<sup>29</sup> Referohuni në pikat 260 – 286 të këtij akti.

<sup>30</sup> Referohuni prg. 166, faqe 67 e vendimit.

<sup>31</sup> Regjistruar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2021.

Shkallës së Parë, Kavajë me kërkesën për pushimin<sup>32</sup> e çështjes penale, me argumentin se është parashkruar ndjekja penale për shkak të kalimit të kohës së gjatë nga koha e kryerjes së veprës (më shumë se 20 vjet).

22.2.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kavajë, në datën \*\*.9.2020, ka vendosur:<sup>33</sup> *kthimin e akteve prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore*, sipas pjesës arsyetuese të vendimit dhe ka vlerësuar se kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Kavajë, me objekt: “Pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* të vitit 2019, hetuar për kryerjen e veprës penale të ‘Shpërdorimit të detyrës’, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, dhe ‘Falsifikimit të dokumenteve’, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal”, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin procedural penal dhe, referuar neneve 328-329/b, të K. Pr. Penale, nuk duhet pranuar.

22.2.3 Gjykata, në vendimin e saj, ka listuar<sup>34</sup> detyrat për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Kavajë dhe ka çmuar se për kryerjen veprimet procedurale dhe veprimet e mësipërme prokurorit duhet t’i lihet një kohë prej 3 (tre) muajsh nga momenti i kthimit të akteve (efektivisht).

22.2.4 Në datën \*\*.11.2020, në funksion të hetimit të këtij procedimi, prokurori Çopa: (i) ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetases, \*\*\* \*\*\*, si person nën hetim si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal; (ii) ka vendosur disa herë zgjatjen<sup>35</sup> e afatit të hetimeve me periudha 3-mujore, në lidhje me këtë procedim penal.

22.2.5 Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, në datën \*\*.10.2021, prokurori Çopa, i është drejtuar Gjykatës me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2018.

<sup>32</sup> Në mbështetje të nenit 66, germa “c” e “ç” të Kodit Penal dhe të nenit 328, pika 1, germa “b”, të K. Pr. Penale.

<sup>33</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kavajë me nr. \*\*.2020.\*\*\* (\*\*\*) , datë \*\*.9.2020.

<sup>34</sup> Gjykata ka konstatuar se: *Së pari*, nga ana e Prokurorisë, nuk është regjistruar emri i shtetases \*\*\* \*\*\* si person që i atribuohet vepra penale e “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i K. Penal, edhe pse për këtë fakt ka të dhëna të mjaftueshme. Indirekt prej organit të akuzës pranohet se AMTP-ja mund të jetë falsifikuar. Kjo AMTP mban emrin e shtetases \*\*\* \*\*\*; është regjistruar pranë ish-ZVRPP-së Kavajë dhe me të janë kryer veprime ndër vite. Pra, ka të dhëna të mjaftueshme për të regjistruar emrin e saj si shtetase nën hetim. *Së dyti*, nuk është pasqyruar mekanizmi i veprës penale, pra falsifikimit dhe kujt i atribuohet ajo. Nuk është përcaktuar momenti i falsifikimit, pasi, siç pretendohet nga viktimja, në të pasqyrohen të dhëna, të cilat nuk janë ditur në vitin 1996, që prezumohet se është lëshuar, siç janë numrat e pasurive, pasi pretendohet se zona në fjalë është azhurnuar vite më vonë dhe nuk kishte si të dihejshin në vitin 1996 këto numra pasurie. *Së treti*, nuk është identifikuar personi që e ka paraqitur për regjistrim, personat zyrtarë që e kanë regjistruar dhe cilët janë personat zyrtarë që i kanë refuzuar regjistrimin e pasurisë viktimës \*\*\* \*\*\*. Të identifikohen, të pyeten këta në lidhje me faktin se ku janë bazuar për regjistrim; pse ia kanë refuzuar regjistrimin shtetasit \*\*\* \*\*\* dhe a kanë vendosur ndonjë urdhër kufizimi mbi pasurinë në momentin që kanë vërejtur dy tituj pronësie dhe nëse kanë marrë ndonjë masë verifikuese. Kufizimi i kësaj pasurie është bërë vetëm në vitin 2019, pasi janë lënë detyra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. *Së katërti*, duhet të pyeten personat që e kanë lëshuar AMTP \*\*\* , kryetari \*\*\* \*\*\* dhe përfaqësuesi i rrethit, \*\*\* \*\*\*. Të verifikohet nëse kontrata e shitblerjes e datës \*\*.12.2000, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., e lidhur midis shitëses \*\*\* \*\*\* dhe shtetasit \*\*\* \*\*\*, pranë noterit \*\*\* \*\*\* ekziston, ose jo, si dhe të pyetet noteri dhe shtetasi \*\*\* \*\*, në lidhje me mënyrën se si është lidhur me shitësen dhe kushtet e kontratës, i njëjti veprim të kryhet edhe në lidhje me kontratën e shitblerjes të datës \*\*.10.2000, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., lidhur prej shtetases \*\*\* \*\*\* dhe shtetasit \*\*\* \*\*\*, pranë noterit \*\*\* \*\*\*. *Së pesti*, duhet të përcaktohet nëpërmjet një eksperti topograf nëse pasuritë e fituara nëpërmjet AMTP-së \*\*\* , nga shtetasja \*\*\* \*\*\*, mbivendosen me ndonjë tjetër pasuri, si edhe të përcaktohet fakti nëse, në vitin 1996, që është data e lëshimit të kësaj AMTP-je, ekzistonin numrat e pasurive të vendosura për to, apo azhurnimi i zonës është kryer më pas. Gjithashtu të hetohet se si ka kaluar në pronësi të shtetases \*\*\* \*\*\* pasuria nr. \*\*/\*, kur nuk ka një titull pronësie dhe, në bazë të listës emërore të trojeve dhe shtëpive të fshatit Spille, kjo pasuri i përket shtetasit \*\*\* \*\*\*. Të hetohet se kush e ka kryer këtë regjistrim. Për sa i përket pretendimit të organit të akuzës për parashkrim të veprës penale, gjykata vlerëson se veprat penale të kallëzuara mund të jenë vazhduese dhe njëkohësisht nuk është përcaktuar saktë mekanizmi i kryerjes së tyre për të konkluduar, apo për të zgjidhur pasojat.

<sup>35</sup> (1) Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, datë \*\*.2.2021, me arsyetimin se, pasi janë kryer disa veprime hetimore, është e nevojshme kryerja edhe e disa veprimeve të tjera hetimore, gjithashtu është e nevojshme kryerja e aktit të ekspertimit topografik; (2) Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, datë \*\*.5.2021, me arsyetimin se është e nevojshme kryerja edhe e disa veprimeve të tjera hetimore, gjithashtu datë \*\*.3.2021 është marrë vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik dhe deri në paraqitjen e këtij akti është e nevojshme zgjatja e afatit të hetimeve; (3) Vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, datë \*\*.7.2021, me arsyetimin se, pasi janë kryer disa veprime hetimore, është e nevojshme kryerja edhe e disa veprimeve të tjera hetimore, gjithashtu, meqenëse më datë \*\*.7.2021, është paraqitur akti i ekspertimit topografik, me të cilin duhet të njihen palët dhe meqë periudha përkon me lejen vjetore të institucionit.

22.2.6 Në datën \*\*.7.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kavajë ka vendosur<sup>36</sup>: (1) *Kthimin e akteve pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Kavajë*; (2) Urdhërimin e Prokurorisë për kryerjen e veprimeve hetimore të cituara në pjesën arsyetuese të vendimit dhe; (3) Lënien e një afati hetimor për plotësimin e veprimeve hetimore, duke arsyetuar, ndër të tjera, se veprimet hetimore janë të paplota<sup>37</sup>, vendim kundër të cilit ka ushtruar ankim prokurori, subjekti i rivlerësimit<sup>38</sup>, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit, lënien në fuqi të kërkesës për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2019.

**22.3** Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] *nga prokurori Çopa ka patur mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore, si edhe evidentohet moskryerja në kohë e tyre, rrethana të cilat kanë çuar edhe në zvarritje të procesit. Duket se nuk janë plotësuar as detyrat hetimore të lëna nga Gjykata. Në këtë kontekst, Komisioni kërkon të listoni veprimet hetimore të kryera nga ana juaj nga momenti i marrjes për shqyrtim të kësaj dosje deri në momentin që keni bërë kërkesën e parë për pushimin e procedimit, e në vazhdim nga momenti i kthimit të akteve nga Gjykata deri në momentin që keni bërë kërkesën e dytë për pushimin e procedimit [...]. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij në aktin “Shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ...”<sup>39</sup>.*

**22.4** Komisioni, në përfundim, pas shqyrtimit të këtij denoncimi dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin<sup>40</sup> se [...] *ngrihen pretendime, hidhen dyshime dhe/apo duket se evidentohen gjetje si më poshtë: Në një rast duket se ka pasur mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe/apo moskryerjen në kohë të tyre, madje duke mos u plotësuar as detyrat e lëna nga Gjykata, rrethana të cilat kanë çuar edhe në zvarritje të procesit [...].*

**22.5 Komisioneri Publik** vlerëson se dhe ky rast duhet vlerësuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, së bashku me gjetjet e tjera në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës për mospërmblidhjen e detyrave të lëna nga Gjykata. Rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë në respektimin e afateve ligjore, të aftësisë për të kryer me efekt procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të Prokurorisë, referuar indikatorëve të përcaktuar nga neni 74, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016.

**23.** Në përfundim të vlerësimit të gjetjeve, të lidhura me figurën dhe vlerësimin e aftësive profesionale, **Komisioneri Publik** vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit afektojnë kriterin e aftësisë profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pika 3, nenin 74, pika 2 dhe 4, dhe nenin 75, pika 3 të ligjit nr. 96/2016. Problematikat e konstatuara më sipër duhen trajtuar nga Kolegji eventualisht së bashku me gjetjet e tjera të shkaqeve të ankimit, nën

<sup>36</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kavajë, me nr. \*\*-2022-\*\*\* (\*\*), datë \*\*.7.2022.

<sup>37</sup> Sipas vendimit të Gjykatës, kërkesa e paraqitur nga Prokuroria nuk është e plotë, pasi do të duhej të kishte kryer veprime më të thella hetimore sipas urdhërimeve të dhëna nga Gjykata me vendimin nr. \*\*-2020-\*\*\* (\*\*\*), datë \*\*.9.2020, dhe të merrte informacione shtesë në lidhje me arkivin e noterit \*\*\* \*\*\*, se cilit person i ka kaluar ky arkiv. Në vijim të arsyetimit, Gjykata ka parashtruar se: Prokuroria nëse do të arrinte në konkluzionin se ka kaluar afati 20-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, do të duhej të bënte disponimet përkatëse në lidhje me AMTP nr. \*\*/\*\*, duke bërë disponimet që çdo akt juridik i derivuar nga ana e saj të konsiderohej i pavlefshëm dhe ky vendim t'i njoftohej ASHK-së, për të vendosur kufizimet përkatëse. Ndaj parashtron se kërkesa është e paplotë, pasi nuk janë plotësuar detyrat hetimore të dhëna nga Gjykata. Po ashtu, Gjykata vlerëson se duhet hetuar në drejtim të veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287, i Kodit Penal, në drejtim të së kallëzuarës \*\*\* \*\*\*, pasi rezultoi se, me vetëdije, ka përdorur një akt të falsifikuar.

<sup>38</sup> Ankimi i dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës dhe për dijeni Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës.

<sup>39</sup> Referohuni në pikat 159 – 225 të këtij akti.

<sup>40</sup> Referohuni prg. 159.1 dhe 159.1.1, faqe 63 e vendimit.

frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të aplikimit të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**24.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

**25.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**26.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

**27.** Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**28.** Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 738, datë 22.2.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Gëzim Çopa.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**